



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.30/2021
Me.28.01.2021

Duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale e në harmoni me Rregulloren Komunale Nr.03/2019 për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Istogut ,Drejtori Komunal i Arsimit në Istog shpall këtë:

K o n k u r s

I. Për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2020/2021

- Bursat ndahen për vitin akademik 2020/2021 për shkollimin universitar themelor.
- Numri i Bursave të planifikuara 30 (tridhjetë)
- Bursat akordohen me kohëzgjatje prej nje 1 (një) viti akademik më të drejtë vazhdimi, nëse përfituesi i bursës e ka regjistruar më sukses vitin pasues.
- Lartësia e bursës është 50 euro (pësdhjetë euro) për muaj respektivisht në shumën e përgjithshme prej 600 euro (gjashqind euro) për vitin akademik të studimeve.

II. Kriteret për ndarjen e bursave

Kandidatët vlerësohen sipas kriterëve si me poshtë:

- Studentët e familjeve të cilët nuk kanë asnjë anëtar nga familja e ngushtë të punësuar dhe nuk krijojnë të ardhura nga asnjë veprimtari, dëshmohet me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, vërtetimet duhet të jenë për secilin anëtar të familjes së ngushte që kanë moshën mbi 18 vite, prandaj mos sjellja e vërtetimit të ndonjërit prej anëtareve të familjes do të pasoj, me mos njohje të pikëve të parapara në këtë kategori kjo kategori **vlerësohen me 10 pikë**
- Studentët të cilët nga familja e ngushtë kanë një anëtar me nevoja të veçanta **vlerësohen me 5 pikë;**
- Studenti i vetëm nga familja e ngushtë **vlerësohet me 5 pikë**,dy student **vlersohën me 10 pikë**, tre e me shumë **vlersohën me 15 pikë.**
- Studentët nga familja në asistencë sociale **vlersohën me 10 pikë.**
- Studentet me nevoja të veqanta **vlersohën me 15 pikë.**
- Studentet nga familja e ngusht e deshmorit,**vlersohen me 15 pikë.**
- Studentet nga familja e ngusht e invalidit të luftës,nga familja e ngusht e veteranit të luftes ,studentet e viktimave civile të luftes **vlersohën me 10 pikë.**
- Studentet pa të dy prindërit **vlersohen me 15 pikë** ndërsa ata me njërin prind **vlersohen me 10 pikë.**
- Studentet të cilët vijnë nga drejtimit deficitare të përcaktuara me nenin 4 të kësaj Rregullorje **vlersohen me 10 pikë.**

Në rast së studentët grumbullojnë pikë të njëjta,përparësi i jepet kandidatëve femra e në rast së kandidatët janë të gjinisë së njëjtë përparësi i jepet kandidatit që studion lëmin deficitare.

Përfitues të bursës janë ata kandidat që arrijnë të bëjnë pikë më shumë duke u renditur në listë.

III. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i kësaj burse nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror (Ministria e Arsimit apo Universiteti) ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë apo i punësuar.

IV. Dokumentet e nevojshme për aplikim për Bursa (Kushtet për Aplikim)

Për realizimin e të drejtës në bursë kandidatët (aplikuesit) duhet t'i plotësojnë kushtet si me poshtë.

- Dokument i identifikimit (kopja e letërnjoftimit);
- Certifikatën e vendbanimit;
- Certifikata apo (Vërtetimi) që deshmon së është student i rregullt dhe të mos ketë humbur vitin shkollorë gjatë studimeve.
- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin vijues të studimeve 2020/2021;
- Certifikatën e bashkësisë familjare.
- Studentët e vitit të parë sjellin kopjet e diplomës dhe dëftesat nga shkolla e mesme të vërtetuara;
- Si dhe vërtetimet për secilën kategori të parapara me pikën 2 të këtij konkursi.

V. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e regjistruar në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës të cilët notën mesatare gjatë studimeve e kanë 7.5 e me lartë ,ndërsa nxënësit të cilët kanë regjistruar vitin e parë të studimeve nota mesatare nga shkolla e mesme duhet të jetë mbi 4.5 e me lartë.

VI. Kohëzgjatja e konkursit:

-Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit përkatësisht, në gazetë ditore ,ne ueb faqen zyrtare të komunës dhe në tabelën e shpalljeve ;

-Aplikacioni mund të tërhiqet në Qendrën për Shërbim me Qytetar ,zyra nr.100 kati përdhes i njejtë pas plotësimit dorëzohet po në të njëjtën zyre.

-Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;

**Drejtori DKA-së
Hajrush Shoshi**

